

PROGRAMI NË VAZHDIM DHE MËSIMET KRYESORE

Banka ka pasur një program aktiv në Shqipëri për më thuajse dy dekada dhe ka mësuar disa gjëra gjatë kësaj periudhe. Mësime janë ndarë në tre fusha kryesore: (i) mësime për implementimin e portofolit aktual; (ii) mësime më të gjera të nxjerra nga vlerësimet e mëparshme të CAS të fundit për periudhën VF06-VF09 dhe nga Studimi i Klientit për 2010; dhe (iii) mësime të marra nga përfshirja me partnerë të tjerë, partnerë të huaj për zhvillim si dhe grupe vendore interesi.

Mësimet e Portofolit Aktual dhe Implementimit

Përkushtimet e portofolit aktual përfshijnë 263 milion US\$ në huat dhe kreditë BNRZH/IDA, 180 milion US\$ në hua dhe kredi me bashkëfinancim, dhe 35 milion US\$ në Fondet e Mirëbesimit të ekzekutuara nga marrësi, që përbëjnë një portofol të konsoliduar (nën mbikëqyrjen e Bankës) prej 480 milion US\$ investimesh në implementim¹. Mbi 40 përqind e këtij portofoli të konsoliduar është disbursuar, me nivele thuajse të barabarta disbursimi për financimet e Bankës dhe TF. Performanca e portofolit është përkeqësuar gjatë viteve të fundit. Në fund të Majit 2010, 10 nga 16 veprimtaritë- duke përfshirë Fondin e Mirëbesimit me Disa Donator IPS, i cili trajtohet si një projekt për shkak të madhësisë – kishin një performancë të kënaqshme apo mesatarisht të kënaqshme. Dy projekte rrugore renditen si shimë të kënaqshëm duke pasur parasysh nivelin shumë të shpejtë të disbursimit dhe rezultatet e deritanishme pozitive. Moshja mesatare e portofolit është 4.5 vjet. Niveli i disbursimit në VF09 ishte 21 përqind, dhe në fundin e Majit 2010 ishte 15.3 përqind për VF10.

Sfidat kryesore për të ardhmen e portofolit janë: (a) *përmirësimi i performancës së implementimit dhe niveleve të disbursimit*, të cilat janë akoma veçanërisht më të ulëta se mesatarja rajonale dhe se mesatarja e përgjithshme e Bankës; (b) *arritja e një balance më të mirë të rreziqeve dhe të ardhurave nga zhvillimi* në të gjithë portofolin; dhe (c) *konsolidimi dhe thjeshtëzimi i portofolit të madh* në një program ndërhyrjesh më të efektshëm dhe të menaxhueshëm.

Rënia aktuale e *performancës së implementimit dhe niveleve të disbursimit* mund t'i atribuohet tre faktorëve kryesor. Së pari, procesit të përfshirjes së marrëveshjeve të implementimit të projekteve në linjë me strukturat ministore i cili ka filluar me kërkesë të Qeverisë në vitin 2004 dhe është aplikuar rigorozisht për projektet e reja gjatë periudhës së CAS-it të fundit. Kjo përfshirje përbën një kurbë të pjerrët mësimi për disa ministri, edhe pse përfitimet janë evidente pas viteve të para të implementimit. Së dyti, sfidat e vazhdueshme të besueshmërisë– si në menaxhimin e prokurimeve ashtu dhe në atë financiar– kanë vazhduar të dëmtojnë implementimin e projekteve. Dhe së fundmi, gjatë periudhës CAS, programi përjetoi një ndërprerje të gjatë të një projekti dhe disa ristrukturime të projekteve madhore si pasojë e shqetësimeve për implementimin dhe politikat mbrojtëse. Tre prej këtyre ristrukturimeve priten të reflektohen në radhitjet e përmirësuar gjatë javëve në vijim, dhe një tjetër në muajt në vijim.

¹ Ky portofol gjithashtu përfshin një Garanci kontingjente të Riskut Parcial prej 78milion US\$, të pa përfshira në numrat e mësipërm të investimeve.

Tabela 1: Performanca e Portofolit deri në 1 Qershor 2010

Sektori	Emri i Projektit	Aprovimi ne Bord	Përfund. i Rishikuar	IDA/BNRZH US\$m	Financ donat* US\$m	Disb (%)	zgjatja (vit)	IP e fundit	DO e fundit
HD	Shpërn. e Shërbimeve Sociale	Qer 2001	Sht 2012	15.0	--	67	9.0	MU	MU
	Cilësia & Barazia e Arsimit	Qer 2006	Dhj 2010	15.0	37.8	43	4.0	MS	MS
	Modern. i Sistemit Shëndet.	Mar 2006	Mar 2012	15.4	1.6	42	4.2	MS	MS
SD	Gjener.& rest. i Sekt. Energj Transporti	Mar 2004	Qer 2010	25.0	112.0	90	6.2	MU	S
	Zhv. i Burimeve Natyrore	Shk 2007	Qer 2011	25.0	15.0	102	3.3	HS	S
	Mnxh. Intg. Liqeni Shkoder	Qer 2005	Nen 2010	7.0	10.0	76	5.0	S	S
	Mnxh. Int. Zona Bregdet.	Qer 2008	Sht 2012	2.0	--	14	1.8	MS	MS
	ECSEE APL 2 (Transmetimi)	Qer 2005	Dhj 2012	17.5	7.8	23	4.9	MS	MS
	Admin & Mnxh Tokës	Qer 2005	Jan 2011	27.0	--	14	4.9	MU	MU
	Gripi Shpendëve	Qer 2007	Dhj 2011	35.0	5.1	17	3.3	MU	MU
	Rrugët Sekondare & Lokale	Qer 2006	Dhj 2010	5.0	0.8	76	3.9	S	S
	ECSEE APL 5 (Sig. Digave)	Qer 2008	Dhj 2012	20.0	15.0	46	2.0	HS	HS
	Përb. & Adapt. I Katastrofave	Qer 2008	Dhj 2013	35.3	--	5	1.9	MS	MS
			Qer 2008	Shk 2012	9.2	--	26	1.9	U
PREM	Sistemi i Intg Planifikimi*	Jan 2008	Sht 2011	--	6.4	20	2.2	MS	MS
PF	Refor. e Mjedisit te bizn. & refor. instit	Tet 2006	Jan 2011	9.3	--	15	3.6	MU	MU
				263	215	42.2	4.5		

* përfshin hua, kredi, dhe fonde grantesh të bashkëfinancuara dhe financuara paralelisht

Si Qeveria ashtu dhe Banka janë të përkushtuara për të vazhduar procesin e *përfshirjes së implementimit në strukturat qeveritare* gjate SPV së re. Përfshirja është në përputhje të plotë me Deklaratën e Parisit dhe vendos piketat për qasje në bazë sektori për ndihmë në zhvillim. Një leksion kyç nga CAS i mëparshëm është se qasja ndaj kësaj përfshirje nuk duhet të jetë “se një krah i mbulon të gjitha” dhe gjithashtu nuk duhet të synojë thjeshtë për eliminimin e njërive të jashtme të zbatimit të projektit (PIUs). Përfshirja mund t’i bëjë projektet më vulnerabël ndaj niveleve të larta të prurjeve të stafit në qeveri. Si e tillë, një mënyrë për të lehtësuar efektin e zëvendësimeve individuale të stafit është ndërtimi i ndërgjegjësimit të gjerë për, dhe përfshirje me, projektin në një shkallë më të gjerë të personelit të ministrive. Axhenda e përfshirjes dhe ndërtimi i kapaciteteve duhet të jetë: (i) i planifikuar me kujdes gjatë hartimit të projektit për të pasur parasysh sfidat specifike të administratës së ministrive përfituese; (ii) të ketë rezultate të orientuara qartë; dhe (iii) të adresojë qartazi kuadrin e rrezeve të projektit për ndikimin e mundshëm ndaj disbursimeve në vitet e parë, dhe për vulnerabilitetin e prurjeve të stafit.

Tabela 2: Tendencat në Nivelet e Disbursimit (% e balancave të padisbursuara)*

	FY05	FY06	FY07	FY08	FY09	FY10	FY05-10
Shqipëria	26	17	25	18	21	15	20
EQA	24	17	19	18	18	17	19
Banka	23	24	23	22	27	24	24

*Shifrat janë rumbullakosur me numrin e plotë më të afërt.

Përsa i takon *aspekteve fiduciare të portofolit*, Vlerësimi i Besimit për Portofolin e Vendit për VF10 (CPFR) dalloj një nivel progresi si në menaxhimin financiar ashtu dhe në atë të

prokurimeve, dhe identifikoi një seri masash që duhen ndërmarrë gjatë kësaj SPV. Shqipëria mbetet një vend me risk të lartë për sa i përket *prokurimeve*, siç reflektohet në nivelin ende të lartë të rryshfeteve të raportuara nga firmat të paguara për të marrë kontrata publike, si përqindje e vlerës së kontratës. BEEPs i vitit 2008 tregoi një reduktim të këtij indikatorit nga 6.7 përqind në 4.4 përqind, ndërkohë që mesatarja e rajonit është 1.5 përqind. Gjithsesi, CPFR për VF10 nuk gjeti çështje madhore për prokurimet në projektet e Bankës. Vlerësimi ia ngarkon këtë mbikëqyrjes së shtuar që u mundësua nga decentralizimi i stafit që merret me ceshtjet fiduciare nga Banka, çka ka qenë relativisht e suksesshme për të ndihmuar lehtësimin e rreziqeve në portofol si dhe për të ndërtuar kapacitete në qeveri. Raporti gjithashtu rekomandon zgjerimin e përdorimit të elementeve tashmë të pranuar të sistemit të vendit, ndërkohë që kërkon të forcojë të tjerat. Për shembull, Banka është tashmë duke mbështetur një audit të sistemit Shqiptar të prokurimeve elektronike me qëllim që ta certifikoj atë për përdorim nga disa partner për zhvillim në të ardhmen. Në fushën e *menaxhimit financiar*, vonesa e shpërndarjes së sistemit të ri të Qeverisë për thesarin ka komplikuar menaxhimin financiar për disa projekte që ishin mandatuar për të përdorur këtë sistem gjatë periudhës së SPV të fundit. Gjithsesi, shpërndarja është tashmë duke u kryer, e mbështetur nga Fondi i Mirëbesimit IPS, dhe pritet të sjellë përmirësime domethënëse në menaxhimin financiar të portofolit.

Të nisur nga këto leksione të SPV aktuale por edhe nga CPFR, Banka do të punojë ngushtësisht me Qeverinë për të implementuar *Planin Veprimi Fiduciar* për të lehtësuar dhe menaxhuar rreziqet fiduciare për projektet me probleme në huadhëniet për investime, menaxhimin e kontratave, pajtimin me auditin, dhe menaxhimin financiar dhe praktikën e prokurimit nga entet zbatuese. *Mbajtja e decentralizimit të stafit të menaxhimit financiar dhe prokurimeve është thelbësor për mbështetur me kosto efikase mbikëqyrjen intensive të besimit (fiduciar) të Portofolit shqiptar, për të lehtësuar rreziqet e larta në prokurime, dhe për të lehtësuar menaxhimin e portofolit më pranë klientit.*

Persa i takon balancës së rreziqeve të portofolit dhe të ardhurave nga zhvillimi, dy mësimet kyç dolën gjatë rasteve të fundit të Panelit të Inspektimit. E para është se kombinimi i të drejtave të dobëta të pronësisë dhe ndërtimet e shumta ilegale në Shqipëri janë një rrezik i konsiderueshëm për një portofol që mbështet një volum substancial investimesh në infrastrukturë dhe reforma të tjera institucionale, si për shembull planifikimi i përdorimit të tokës që mundohet të adresojë shpesh çështje tejet të politizuara të menaxhimit territorial (shih Kutia 2). Në lidhje me investimet në infrastrukturë, Banka ka ndërmarrë një rishikim të afërt të portofolit nga perspektiva për mbrojtjen ndaj këtyre rreziqeve dhe po ndjek rekomandimet për trajnim më të mirë të stafit dhe klientëve zyrtarë mbi politikën e Bankës dhe për të kuptuar më mirë ligjet lokale dhe procedurat nga stafi i Bankës. Një program trajnimi për stafin lokal është kryer tashmë. Banka ka përgatitur gjithashtu një vlerësim për politikën Shqiptare të blerjes së tokës në mënyrë që të identifikojë boshllëqet me politikën e Bankës. Kjo do të jetë baza për një ‘workshop’ trajnimi për zyrtarët e qeverisë në fillimin e VF11. Mësimi i dytë lidhet me *kualitetin e përfshirjes së palëve të interesuara në hartimin e projektit dhe në zbatim.* Si pasojë, programi Shqiptar ka krijuar një Strategji Komunikimi të Zyrës Vendore që rishikohet çdo dy vjet dhe që përfshin një mbikëqyrje më të ngushtë të komunikimit në projekte, ndërveprim më të lartë me palët e interesuara joqeveritare, dhe përgjigje koherente për ankesat dhe pyetjet nga publiku për veprimtarinë e financuar nga Banka.

Me graduimin e Shqipërisë në BNRZH, të dyja dhe Qeveria dhe Banka e njohin nevojën për të konsoliduar numrin e projekteve të vogla në portofol. Ky konsolidim do të jetë i rëndësishëm për një përdorim më efikas të resurseve të Bankës dhe qeverive menaxheriale të Qeverisë, do të lirojë resurset e brendshme për të kryer më shumë punë analitike dhe këshillimore me Qeverinë për sfidat e ardhshme të Shqipërisë, dhe do ta lejojë Bankën të fokusohet në mënyrë selektive në zhvillimin e programeve më të mëdha të donacioneve në kohë. Qëllimi është që të vazhdohet reduktimi në portofol nga 21 projekte në 2004, 15 në 2010, në 10-11 në fundin e periudhës së re CPS.

Kutia 1: Shembjet e ndërtimeve, Politikat Mbrojtëse dhe Planifikimi i Përdorimit të Tokës në Shqipëri

Shqipëria vazhdon të përballet me problemin e ndërtimeve të shumta informale dhe me një kuadër të dobët, edhe pse në përmirësim, të administrimit të tokës. Në këtë ambient, si autoritetet kombëtare dhe ato bashkiake përdorin shembjet si mënyrë për të kontrolluar zhvillimet e paligjshme. Duke pasur këtë parasysh, Qeveria është shprehur se nuk do të bjerë dakord me masat e Bankës për të mbrojtur përkohësisht zona të gjera gjeografike—si për shembull bregun e Jugut apo dhe bashki të tëra – (në krahasim me zona specifike investimi) nga përpjekjet e vazhdueshme për të larguar strukturat ilegale ekzistuese. Masa të tilla, argumentohen se, krijojnë dualitet në sistemin ligjor të vendit për një çështje kaq të gjerë dhe do të ishin një shkelje për principet e barazisë. Edhe pse politikat mbrojtëse të Bankës për strehimet e pavullnetshme nuk përfshijnë aktivitete të planifikimit të përdorimit të tokës që nuk përfshijnë investime të mbështetura nga Banka për marrjen e tokës, rreziku që këto projekte të përfshihen në mosmarrëveshje për sa i përket shembjeve është substancia. Në njohuri të kësaj, Banka është tërhequr nga investimet në aktivitetet planifikuese për përdorimin e tokës në Shqipëri, por do të vazhdojë dialogun për reformë të politikave në këtë fushë kritike përmes asistencës teknike (TA) jo huadhënëse. Me kalimin e kohës, pritet që, me avancimin e zbatimit të Ligjit të ri për Planifikimin e territorit, dhe me përmirësimet e bëra ndaj regjistrimit të pronës, planifikimit urban, dhe dhënies së lejeve të ndërtimit, do të ketë një kufizim të shembjeve për të kontrolluar zhvillimet në përdorimin e tokës dhe në mënyrë më sistematike do të lehtësohen kostot sociale që lidhen me këto veprime.

Mësime nga Raporti Përfundimtar CAS VF06-VF09 dhe nga Studimi i Klientit 2010

Implementimi i CAS VF06-09 nxori në pah leksione të rëndësishme për sa i përket efektivitetit të Bankës në mbështetjen e proceseve të zhvillimit në Shqipëri. Në veçanti, ka disa leksione kyçe që i përkasin përfitimeve të bashkëpunimit të afërt midis Bankës dhe IFC për huadhëniet dhe investimet si dhe për shërbimet këshillimore, efikasiteti i mbajtjes së një dialogu për politikat e zhvillimit pavarësisht nga performanca makroekonomike, mësime për zbatimin e masave mbrojtëse dhe në rolin e Bankës për të sjellë transparencë dhe konsultim.

- ***Bashkëpunim i afërt midis Bankës dhe IFC*** mund të jetë kombinimi i duhur për mbajtjen e reformave komplekse të sektorit privat, siç është parë në privatizimin e kompanisë së shpërndarjes së energjisë elektrike. Bashkëpunimi i IFC dhe Bankës ka qenë kritik dhe për të arritur konsensus në komunitetin e donatorëve për çështje madhore rregullatore dhe për të strukturuar një transaksion atraktiv për sektorin privat. Garancia e pjesshme ndaj rrezikut (PRG) e BNRZH, një instrument financiar i hartuar për të ndihmuar qeveritë në lehtësimin e rreziqeve politike dhe rregullatore,

ka ndihmuar në mbajtjen dhe rritjen e interesit të investitorëve në procesin e privatizimit. Reformat e koncesioneve që janë mbështetur nga Banka përmes huave të bazuara në politika bashkë me mbështetjen e IFC për hartimin e ligjit të ri të koncesioneve, i hapën transaksioneve të reja të shërbimeve këshillimore për IFC përmes përdorimit të ligjit. Gjithashtu, reforma e licensimit e mbështetur nga një projekt i Bankës me udhëheqje teknike nga IFC dhe inovacionet e *Doing Business* të mbështetura nga njësisia e përbashkët Bankë-IFC ishin dy fusha të tjera të suksesshme të bashkëpunimit të afërt midis Bankës dhe IFC.

- ***Reformat e rëndësishme dhe progresi strukturor mund të arrihen edhe pa mbështetje buxhetore, nëse ka pronësi të fortë nga Qeveria për programin themelor të reformës.*** Gjatë periudhës së mëparshme CAS, Banka dhe Qeveria mbajtën një dialog politik të vazhdueshëm i cili solli reforma strukturore kyç, pavarësisht rezultatit eventual që seria e DPL ishte hartuar vetëm për operacionin e parë, për shkak të shqetësimeve për kuadrin makroekonomik.
- ***Zbatimi i politikave mbrojtëse duhet të trajtohet me prioritet në të njëjtën shkallë si dhe kontrollat e besimit gjatë përgatitjes së projekteve dhe zbatimit.*** Së pari, si ekipi i zbatimit ashtu dhe klienti duhet të kenë një kontroll më të mirë të politikave dhe mënyrës se si ato implementohen. Së dyti, stafi përgjegjës për rishikimin e kuadrove të politikave mbrojtëse (p.sh. Kuadri i Politikave të Strehimit dhe Planet e Menaxhimit Mjedisor) duhet të kenë një kuptim të qartë të ligjeve dhe procedurave lokale, dhe të paqartësive apo boshllëqeve specifike të tyre përball politikave të Bankës. Së fundmi, Banka duhet të sigurojë se aplikimi i këtyre politikave është i qëndrueshëm për të gjithë projektet, sektorët dhe vendet, duke u siguruar se specialistët e zhvillimit social, skuadrat ligjore të vendit dhe stafi i kontrollit të kualitetit ndajnë njohuri të përbashkëta se si politikat duhet të zbatohen në raste të ndryshme.
- ***Banka ka luajtur një rol të rëndësishëm sjelljen e transparencës dhe këshillave në Shqipëri, përmes projekteve të saj dhe përmes atyre projekteve që lidhen me zbatimin e portofolit.*** Gjatë periudhës së CAS së mëparshme, mbikëqyrja më e afërt e Bankës për sa i përket konsultimeve solli ndryshime të rëndësishme, edhe pse të lehta, në kulturën e këshillimit në shërbimet publike Shqiptare. Së dyti, gjatë rasteve të Panelit të Inspektimit, Banka mësoi disa leksione të rëndësishme dhe shumë publike për sa i përket nevojës për të mbajtur linja të hapura komunikimi me median dhe publikun e përgjithshëm, por edhe se sa e rëndësishme është që të gjithë palët e interesuara – publiku i përgjithshëm, përfituesit e projektit, shoqëria civile, Parlamenti, qeveria – të kenë një kuptim më të plotë të mënyrës se si Banka punon në Shqipëri. Së treti, shoqëria civile vazhdon ta shohë Bankën dhe partnerët e tjerë ndërkombëtar si një zë i pavarur i çështjeve të zhvillimit.

Në vitet 2009/10, një studim i klientit mbi këndvështrimet e liderëve të opinionit për Bankën Botërore dhe punën e saj në Shqipëri gjeti një mbështetje relativisht të fortë për rolin e Bankës. Dyqind palë të interesuara – të zgjedhura nga një grup liderësh opinioni në Shqipëri, ku përfshiheshin qeveria, shoqëria civile, media, sektori privat, dhe akademikët – u përgjigjën sondazhit me një shkallë prej 73 përqind. Rezultatet e përgjithshme sugjerojnë se palët e interesuara janë shumë të kënaqura me punën e Bankës në Shqipëri, marrëdhëniet me Bankën, rëndësinë e Bankës në Shqipëri, përkrahjen e saj për prioritetet e vendit për zhvillim, dhe efektivitetin e ndërhyrjeve të Bankës. Pak më shumë se gjysma e përgjigjeve treguan se Banka

duhet të përfshihet më shumë në strategjitë e Shqipërisë për zhvillim, ndërkohë që 44 përqind u shprehën se Banka ishte e përfshirë aktualisht në një nivel optimal. Banka shihet nga të pyeturit si e fokusuar në fusha që ata i konsideronin si prioritet kryesorë. Grupet e interesit janë të shqetësuar thellësisht për çështjet që kanë të bëjnë me ligjin, drejtësinë dhe qeverisjen. Gjetjet e sondazhit sugjerojnë se fokusi i përgjithshëm strategjik i Bankës në Shqipëri (i identifikuar nga të pyeturit si kryesisht varfëria, rritja ekonomike, efektiviteti i qeverisë, dhe infrastruktura) i shkon shumë përshtat me atë çka grupet e interesit mendojnë se Banka duhet të fokusohet në Shqipëri (rritja, të drejtat e pronës, arsimi, qeverisja). Për sa i përket fushave ku duhet përmirësim shumica e gjetjeve tregon sugjerime të vazhdueshme se: (i) Banka duhet të punojë më shumë me qeveritë lokale dhe sektorin privat; dhe (ii) Banka duhet të shkojë shumë më tej në bërjen publike të punëve të saj me Qeverinë.

Partneriteti dhe Përfshirja

Partneriteti i Donatorëve. WBG vazhdon të jetë donatori i dytë më i madh në Shqipëri pas Komisionit Evropian (EC) për sa i përket disbursimeve, me rreth 60 milion US\$ çdo vit (shih Aneksi 7). Ky pozicionim e ka lejuar Grupin e Bankës që të ndihmojë qeverinë për të koordinuar asistencën e donatorëve dhe të mobilizojë financime për programe të sektorëve kyç, me sukses të konsiderueshëm. Një pjesë domethënëse e përkushtimeve në portofolin aktual të Bankës është e bashkë-financuar me partnerë të tjerë, në nivelin prej 0.8 të bashkëfinancimit për çdo dollar të financimeve të bankës, pra rreth 215 milion \$ në financime të përbashkëta apo paralele nga 260 milion US\$ të huave dhe kredive IDA/BNRZH. Këtu përfshihet dhe një qasje për të gjithë sektorin, Projekti i Epërsisë dhe Barazisë në arsim i cili ka një nivel prej 2.5 për secilin dollar të financimeve të Bankës. Në mënyrë të veçantë, Fondi i Projektit të Rrugëve Dytësore dhe Lokale prej 20 milion US\$ nga IDA dhe \$15 milion bashkë-financim nga Organizata e Vendeve Eksportuese të Naftës (OPEC) ka qenë pjesa qendrore e një programi *financimit paralel* për rikonstruktimin e rrugëve prej rreth 430 milion US\$. Banka gjithashtu po menaxhon një Fond Besimi të Disa Donatorëve prej 6 milion US\$ për një grup prej 6 donatorësh, dhe një shërbim inovativ të bazuar në pagesë me programin One të OKB në Shqipëri. Së fundmi, përmes përdorimit të instrumentit të Garancisë së Pjesëshme për Rrezikun për privatizimin e kompanisë së shpërndarjes, Banka ka gjithashtu mbështetur sipërmarrje të investimeve private në sektorin e energjisë elektrike në një nivel të përafërt prej 3.2 dollar secili për garanci. IFC ka qenë gjithashtu e suksesshme në mobilizimin e mbështetjes nga një rang i gjerë partnerësh për zhvillim për shërbimet e saj këshillimore dhe asistencën teknike.

Më tej, Banka dhe IFC duhet të vazhdojnë të eksplorojnë mënyra inovative me qeverinë për të grumbulluar-për financimet private për zhvillim për fushat kryesore, në veçanti për pjesëmarrjen private në infrastrukturë ku Shqipëria ka nevojë për investime të mëdha, dhe përshtatjen ndaj klimës, duke pasur parasysh edhe një ekspozim të madh ndaj ndryshimeve klimatike. Grupi i Bankës Botërore do të jete i pranishëm në këto fusha, duke siguruar që mundësitë dhe marrëveshjet e partneritetit nuk i tejpendorin resurset e brendshme për përgatitje dhe mbikëqyrje cilësore të lartë të projekteve, dhe që të kenë sinergji të qarta me programin e përgjithshëm të Bankës. Për më tepër, ndërkohë që KE vazhdon të rrisë mbështetjen e saj për Shqipërinë zgjerimi dhe thellimi i mëtejshëm i bashkëpunimit të Bankës me KE dhe Qeverinë do të jetë e rëndësishme të sigurohet që njohuritë dhe eksperiencat globale të Bankës të mund të ofrojnë informacione në Shqipërinë në përpjekjet e saj për zhvillim.

Pjesëmarrja e grupeve të interesit. Gjatë CAS për VF06-09, Filtri i Qeverisë, ndër të tjera, fokusohet mbi krahun e kërkesës së qeverisjes së mirë, veçanërisht mbi mekanizmat e advokimit dhe rritjen e përfshirjes qytetare për inkurajimin e shërbimeve më të mira publike. Qasja pjesëmarrëse funksionoi veçanërisht mirë në ato projekte që mbështesnin shërbimet lokale dhe të cilat përfshinë pjesëmarrje përfituese në shpërndarjen e shërbimeve sociale, vaditje, punë për komunitetin, pyllëzim, fshatrat bregdetar dhe infrastrukturë bashkiake, rrugë lokale dhe dytësore. Duke pasur parasysh këtë eksperiencë, Banka duhet të konsiderojë mjetet për të thelluar angazhimin e saj me grupet jo-qeveritare dhe ato të shoqërisë civile për implementimin e programeve të saj në Shqipëri. Kjo nuk do të ndihmojë vetëm për të ndërtuar ndërgjegjësim mbi programet e financuara nga Banka në Shqipëri dhe të mbështesë shpërndarjen e politikës së re të Bankës për Akses ndaj Informimit, por ndoshta do të demonstrojë praktika pozitive për Qeverinë në mënyrën se si shoqëria civile mund të përfshihet me efektivitet në monitorimin dhe vlerësimin e projekteve dhe programeve publike.